

# MANUAL PËR AKTIVITETIN E **NËNPUNËSVE** TË ADMINISTRATËS PUBLIKE **NË ZGJEDHJE**

## Përmbajtje

<b>INFORMACION I PËRGJITHSHËM.....</b>	<b>4</b>
1. Qëllimi i manualit? .....	4
4. A parashikohet në ligj fushata në rrjetet sociale? .....	5
5. Cfarë janë burimet publike elektronike/online? .....	6
<b>PËRDORIMI I BURIMEVE PUBLIKE GJATË PERIUDHËS ZGJEDHORE.....</b>	<b>6</b>
6. Kur fillon periudha e monitorimit? .....	6
7. Çfarë janë veprimtaritë publike? .....	6
8. Ku raportohen aktivitetet publike të institucioneve shtetërore?.....	7
9. Kush i raporton veprimtaritë publike? .....	8
10. Cilat janë disa nga ndalesat në një veprimtari publike? .....	8
11. Cilat janë veprimtaritë e ndaluara 4 muaj përpara zgjedhjeve? .	
12. Kush vendos për ndalimin e zhvillimit të një veprimtarie publike? 10	
13. A mund të publikohen në media aktivitetet e ndaluara? .....	10
14. Cilat janë sanksionet në rastet e mosraportimit të veprimtarive publike? 10	
15. Çfarë janë burimet publike dhe kur kemi të bëjme me keqpërdorim të tyre? .....	11
16. A lejohet të marrë pjesë në një aktivitet zgjedhor një nënpunës publik ose punonjësi i administratës shtetërore?.....	12
17. A ndalohet pjesëmarrja e një nënpunësi ose punonjësi të adiminsitratës publike në aktivitete zgjedhore gjatë orarit zyrtar të punës? 12	
18. A lejohet përdorimi i automjetetit të institucionit shtetëror për qëllime zgjedhore? .....	13
19. A përbën vepër penale keqpërdorimi i burimeve publike? .....	13
<b>FINANCIMI I FUSHATAVE ZGJEDHORE DHE PARTIVE POLITIKE .....</b>	<b>14</b>
20. Si financohen partitë politike? .....	14
21. Çfarë lloj mbeshtetje financiare nga shteti iu vihet në dispozicion partive politike? .....	15
22. Sa para mund të marrin partitë nga burimet private? .....	17
23. Çfarë konsiderohet një dhurim anonim? .....	17
24. Kujt i ndalohet të dhurojë për shkak të konfliktit të interesit?.....	18
25. Çfarë rregullash të tjera zbatohen për dhurimet? .....	18
26. Çfarë është një dhurim në natyrë? .....	19
27. Çfarë do të thotë "të ardhura të gjeneruara nga aktivitetet e tjera të kryera nga partia"? .....	19
28. A ka limit lidhur me totalin e shpenzimeve që një partie politike mund të kryejë për fushatën zgjedhore? .....	20
29. Çfarë parashikon ligji për transparencën e partive dhe financimin e zgjedhjeve? .....	20
30. Kush duhet të dorëzojë raportet e financimit të fushatës?.....	21
31. Çfarë informacioni duhet të përfshihet në raportet e financimit të fushatës zgjedhore?.....	21
32. Si e monitoron KQZ-ja fushatën zgjedhore? .....	22
33. Kush mund të denoncojë dhe si bëhet denoncimi në KQZ? ....	22
34. Çfarë sanksionesh parashikohen për shkeljen e ligjit? .....	23

35. Çfarë hapash ndërmarren sa i përket mbikëqyrjes dhe respektimit të ligjit?..... 24

**MODELE NDERKOMBETARE TE NDALIMIT TE PERDORIMIT TE MEDIAVE SOCIALE NGA FUNKSIONARET PUBLIK NE ZGJEDHJE..... 25**

36. Këshilla praktike për zyrtarët publikë lidhur me postimet në mediat sociale sipas praktikave më të mira ndërkombëtare? .....**Error!**  
**Bookmark not defined.**

37. A ndalohen reklamat politike sipas standarteve të BE??..... 25  
38. A ndalohen reklamat politike sipas standarteve të BE?..... 26

**LEGJENDA E SHKELJEVE TË KONSTATUARA NË ZGJEDHJE..... 26**

39. Zhvillimi i takimit elektoral në shkollë (neni 91, pika 2, Kodi Zgjedhor)..... 26  
40. Zhvillim i fushatës në institucion publik (Neni 78, pika 6, Kodi Zgjedhor)..... 27  
41. Vendasja e posterave elektoral në institucion publik (Udhëzimi nr.6, datë 23.03.2021, i KSHZ-së)..... 27  
42. Subjektet zgjedhore/kandidatët i ofrojnë ose japin para, të mira materiale, premtojnë vende pune (neni 78, pika 7, Kodi Zgjedhor). ..... 27  
43. Subjekti zgjedhor/kandidati organizon ose mbulon shpenzimet për koncerte, evente kulturore dhe argëtuese ose aktivitete bamirësie (Neni 78, pika 9, Kodi Zgjedhor)..... 28  
44. Subjekti zgjedhor/Kandidati që ofron artikuj ose materiale të printuara me vlerë prej më shumë se 5(pesë) qind Lekë për artikuj ose materiale zgjedhore (Neni 78, pika 10, Kodi Zgjedhor) ..... 28  
45. Paraqitja e materialeve propagandistike statike më shumë se 5 metra nga zyrat zgjedhore (Neni 79, pika 2, Kodi Zgjedhor) ..... 29  
46. Mos përfshirja e deklaratës së autorizimit në materialet vizive të fushatës propagandistike (Neni 79, pika 3, Kodi Zgjedhor) ..... 29  
47. Zyrat zgjedhore janë hapur në një distancë më të vogël se 300 metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve. (Udhëzimi nr.6, datë 23.03.2021, i KSHZ-së) ..... 29  
48. Përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qelime zgjedhor (Neni 91, pika 2, Kodi Zgjedhor) ..... 29  
49. Punësimi, pushimi nga puna, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucione ose ente publike gjatë fushatës zgjedhore, përveç rasteve të justifikuara (Neni 91, pika 3, Kodi Zgjedhor) ..... 30  
50. Ndalimi në propozimin, aprovimin ose nxjerrjen e akteve ligjore ose akteve nënligjore që përfitojnë kategori të caktuara të njerëzve (p.sh. roga, rritja e pensionit, amnistia fiskale) (Neni 91, pika 4, Kodi Zgjedhor) 30  
51. Mosraportimi i aktiviteteve të natyrës publike të kryer nga institucione publike vendore dhe qëndrore, si dhe agjensi shtetërore dhe/ose ndërmarrje (Neni 92, pika 1 dhe 6, Kodi Zgjedhor)..... 31  
52. Kryerja e aktiviteteve të ndaluara nga KQZ-ja (Neni 91, pika 5, Kodi Zgjedhor dhe vendimi nr.9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator) 32

Ky publikim është financuar nga Bashkimi Evropian. Përbajtja e tij është vetëm përgjegjësi e Qëndresës Qytetare dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

© 2024 Qendresa Qytetare, Tirana, Albania. Te gjitha te drejtat e rezervuara

Autor: © QENDRESA QYTETARE

Adresa: Rr. "Ali Pashe Gucia", Pallati Nr. 42, Kati 0  
Tiranë, Shqipëri

Email: [gendresaqytetare@gmail.com](mailto:gendresaqytetare@gmail.com)

Web: [WWW.qq.com.al](http://WWW.qq.com.al)

## INFORMACION I PËRGJITHSHËM

### ? 1 Qëllimi i manualit?

Kjo paketë udhëzuese parashtron qasjen e organizatës Qëndresa Qytetare ndaj monitorimit të periudhave zgjedhore me fokus partitë politike, administratën publike dhe median. Gjithashtu ky material synon të japë një informacion të strukturuar dhe detajuar mbi parandalimin e përdorimit të burimeve publike, kryesisht mediat digjitale dhe rrjetet sociale të institucioneve dhe personave nga zyrtarët publike.

### ? 2 Si përdoret ky Manual?

Manuali mbështetet tek legjislacioni zgjedhor në vend dhe standardet ndërkombëtare përkatëse për zgjedhjet demokratike. Qëllimi është të pasqyrohet një paketë elementesh që duhen marrë parasysh për angazhimin dhe aktivitetin e zyrtarëve publikë në zgjedhje. Manuali përmban përgjigje për shumë pikpyetje që janë ngritur gjatë zgjedhjeve të kaluara në proceset e hetimit administrative në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve por edhe në denoncimet publike të organizatave dhe subjekteve zgjedhore.

### ? 3 A parashikohet në ligj fushata në rrjetet sociale?

- a Kjo formë e bërjes së fushatës nisur nga baza ligjore sot në fuqi për financimin dhe kontrollin e financiar të partive politike dhe kandidatëve të saj në fushatë, nuk është e rregulluar me norma

ligjore dhe rrjedhimisht nuk mund të pretendohet për norma nënligjore të rregullimit të saj. Monitorimi i fushatës nëpërmjet medias sociale ka një boshllëk ligjor për faktin se në kohën e hartimit të legjislacionit zgjedhor fenomeni i medias sociale ishte pak i njohur dhe pa ndikim.

- b** Bërja e fushatës nëpërmjet medias sociale, nuk monitorohet dhe nga ana tjetër implikon dhe burime të tjera publike të cilat aktualisht, ligji kufizon përdorimin e tyre në fushatë.

#### **4 Cfarë janë burimet publike elektronike/online?**

- a** Burimet përfshijnë burime fizike dhe elektronike, çdo pronë e luajtshme dhe e paluajtshme, teknologji, para, punonjës të tjerë të autoritetit publik, logot ose imazhet, ose çdo gjë tjetër që mund të konsiderohet në mënyrë të arsyeshme si e lidhur me autoritetin publik.
- b** Media sociale dhe përdorimi saj në zgjedhje duhet të fokusohet në hartimin dhe miratimin e udhëzuesve ku të qartësohet se organet publike kanë media sociale 'zyrtare', të cilat më pas mund t'i nënshtrohen mbikëqyrjes nga institucionet si KQZ. Këto kanale zyrtare do të duhet të bëhen "zëri" i njohur i organit, që do të thotë se llogaritë private nuk duhet të konsiderohen se përfaqësojnë "zërin" e organit publik.
- c** Megjithatë, kjo qasje duhet të veprojë si një pengesë për detyrimin e individëve për të

postuar materiale politike në llogaritë e tyre private gjatë orarit të punës ose në cilësinë e tyre zyrtare.

## **5** Cfarë kuptojmë me promovim të një kandidati në zgjedhje?

Promovimi i një kandidati ose partie politike është çdo veprim që:

- a) Demonstron mbështetje për, ose ka efektin e rritjes së reputacionit ose perspektivës zgjedhore të një partie ose kandidati, ose
- b) Demonstron kundërshtim ose ka efektin e dëmtimit të reputacionit ose perspektivës zgjedhore të një partie ose kandidati.

## **PËRDORIMI I BURIMEVE PUBLIKE GJATË PERIUdhËS ZGJEDHORE**

### **6** Kur fillon periudha e monitorimit?

Periudha e monitorimit fillon 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve dhe përfundon ditën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit. Më pas nis vëzhgimi i procesit të numërimit dhe shpalljes së rezultatëve, i cili zgjat rreth 24 – 48 orë.

### **7** Cfarë janë veprimtaritë publike?

Një veprimtari është publike kur ajo do të pasqyrohet sipas rastit në radio, në television, në shtyp, ne median

online, në rrjetet sociale ose nëpërmjet çdo mjeti tjetër që mundëson publikun e gjerë të njihet apo informohet mbi atë veprimtari.

Organizimi i veprimtarive publike duhet të raportohet në KQZ.

## **8** Ku raportohen aktivitetet publike të institucioneve shtetërore?

Aktivitetet e institucioneve publike, qendrore ose vendore, si dhe agjencive ose ndërmarrjeve shtetërore, të cilat organizohen në periudhën 4 muaj përpara zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve dhe që zhvillohen në prezencë të medias dhe/ose në prani të publikut, duhet të raportohen në faqen e internetit të KQZ.

Sekretari i përgjithshëm i institucionit publik qendror ose vendor, drejtori i përgjithshëm ose drejtuesit më të lartë administrative të agjencive dhe institucioneve në varësi të kryeministrit, drejtuesit ekzekutive të shoqërive tregtare ku shteti ka kapitale, kuota apo aksione me shumë se 50% të tyre, drejtuesit ekzekutive të enteve ose ndërmarrjeve shtetërore, si dhe administratorët e njësive administrative mund të aksesojnë faqen e internetit të raportimit duke kërkuar kredencialet e hyrjes në e-mailin [institucion@kqz.gov.al](mailto:institucion@kqz.gov.al) Raportimi i aktivitetit publik mund të dërgohet edhe nëpërmjet postës fizike ose asaj elektronike në e-mailin [institucion@kqz.gov.al](mailto:institucion@kqz.gov.al)



## **?** 9 **Kush i raporton veprimtaritë publike?**

Drejtuesi i administratës së institucionit duhet të raportojë jo më vonë se 5 ditë para organizimit të aktivitetit të planifikuar duke dhënë informacion për datën, orën, vendin, nivelin më të lartë të pjesëmarrjes, folësit dhe detajet e tjera të zhvillimit të aktivitetit publik.

Vetëm institucioni/subjekti që organizon aktivitetin publik ka detyrimin për të raportuar pranë KQZ. Folësit dhe pjesëmarrësit e ftuar në këtë aktivitet nuk kanë detyrimin për të raportuar të njëjtin aktivitet.

## **?** 10 **Cilat janë disa nga ndalesat në një veprimtari publike?**

Në veprimtaritë publike të organizuara institucionet publike, qendrore ose vendore dhe agjencitë ose ndërmarrjet shtetërore në periudhën 4 muaj përpara zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve është i ndaluar përdorimi i shenjave, logove, sloganeve, pankartave, posterave dhe materialeve të tjera propagandistike që identifikojnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi një parti politike apo kandidat në zgjedhje.

Gjatë zhvillimit të veprimtarisë publike ndalohen thirrjet, mesazhet apo fjalimet me përmbajtje partiake ose zgjedhore në favor të një partie apo kandidati në zgjedhje.

## ? 11 Cilat janë veprimtaritë e ndaluara 4 muaj përpara zgjedhjeve?

- a Shpërndarja në aktivitete me prezencë të medias dhe publikut i lejeve të legalizimeve, çertifikatave të pronësisë, akteve për regjistrimin e tokës bujqësore ose rregjistrimi i titujve të tjerë të pronësisë sipas legjislacionit në fuqi.
- b Promovimi i veprimtarive për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, dhe që përfshijnë investime në fushën e transporteve, të energjitikës, të telekomunikacionit, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet në shërbim dhe interes të publikut.
- c Dhënien e kontratave publike të koncensionit/partneritet publik privat (PPP) për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen ose nuk janë vijim i një procedure koncensionare të identifikuar dhe nisur, apo parashikuar për t'u financuar.
- d Përdorimin e detyruar në fushatë të nëpunësve ose punonjësve administratës shtetërore qëndore ose vendore brenda orarit të punës për veprimtari ose aktivitete zgjedhore, përfshirë edhe me mjetet të komunikimit elektronik, si dhe përdorimin brenda orarit mësimor të nxënësve të arsimit 9 vjeçar dhe të mesëm në veprimtari ose aktivitete zgjedhore, si dhe premtimin për përfitime prej tyre në rast se marrin pjesë në to apo ushtrimin e çdo lloj presioni për këtë qëllim.

## **?12** Kush vendos për ndalimin e zhvillimit të një veprimtarie publike?

Në rast se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve, konstaton se veprimtaria publike përbën veprimtari të ndaluar ose keqpërdorim të burimeve shtetërore, urdhëron ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë publike.

Ndalimi kryhet nëpërmjet vendosjes së shënimit "Ndaluar nga KQZ-ja" në ndërfaqen e raportimit, në pjesën që i takon veprimtarisë.

## **?13** A mund të publikohen në media aktivitetet e ndaluara?

Për veprimtaritë publike të ndaluara Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve njofton menjëherë institucionin dhe Autoritetin e Mediave Audiovizive.

Veprimtaritë e ndaluara nuk lejohet të transmetohen apo pasqyrohen në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione. Transmetimi ose pasqyrimi i tyre në kundërshtim me ndalimin e vendosur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ngarkon me përgjegjësi transmetuesin radioteleviziv.

## **?14** Cilat janë sanksionet në rastet e mosraportimit të veprimtarive publike?

Mosraportimi, raportimi i pjesshëm ose jashtë afatit i aktiviteteve të institucioneve me karakter publik,

përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë.

Në rastet kur titullari i institucionit ka penguar raportimin, ka ndikuar apo urdhëruar që aktiviteti të raportohet me vonesë, apo në rastet kur aktiviteti publik është zhvilluar pavarësisht ndalimit të bërë nga KQZ-ja, titullari ndëshkohet me gjobë nga 10 000 deri në 50 000 lekë.

Ankimimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të gjobës së vendosur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

## **?15 Çfarë janë burimet publike dhe kur kemi të bëjme me keqpërdorim të tyre?**

Burime publike quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucioneve publike.

Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet:

- a** përdorimi i aseteve dhe sendeve në pronësi të shtetit.
- d** përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore.
- c** përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore
- d** premtimi ose ofrimi i përfitimeve nënpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

## **?16 A lejohet të marrë pjesë në një aktivitet zgjedhor një nënpunës publik ose punonjës i administratës shtetërore?**

Nëpunësi publik ose punonjësi i administratës shtetërore ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje vetëm pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore,

Edhe gjatë kësaj pjesëmarrje atij i ndalohet të shprehë publikisht bindjet e tij politike ose të bëjë fushatë për një subjekt zgjedhor ose kandidat në zgjedhje.

## **?17 A ndalohet pjesëmarrja e një nënpunësi ose punonjësi të adiminsitratës publike në aktivitete zgjedhore gjatë orarit zyrtar të punës?**

Nënpunësi publik ose punonjësi i administratës shtetërore gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore:

- a** i ndalohet çdo lloj pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politik apo në funksion të politikës partiake ose të kandidatëve, apo në fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje.
- b** i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje.

## **?18 A lejohet përdorimi i automjetit të institucionit shtetëror për qëllime zgjedhore?**

Përdorimi i automjetit ose karburantit në pronësi të institucionit ku ju punoni për veprimtari ose aktivitete të fushatës zgjedhore përbën veprimtari të ndaluar nga Kodi Zgjedhor dhe dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë, por kjo shkelje mund të përbëjë edhe vepër penale, e cila dënohet me burgim nga një deri në tre vite.

Çdo automjet në përdorim ose pronësi të institucionit publik 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve duhet të jetë i parkuar në institucionet respektive pas mbarimit të orarit zyrtar të punës.

Përjashtim bëjnë vetëm automjetet e dedikuara zyrtarëve të lartë, si Shërbimit të Protokollit të Shtetit, të Gardës së Republikës dhe atyre në shërbim të Policisë së Shtetit, në përmbushje të detyrave të tyre funksionale, si dhe rastet e urdhëruara me autorizim për shërbime pune.

## **?19 A përbën vepër penale keqpërdorimi i burimeve publike?**

Përdorimi i aseteve të paluajtshme ose të luajtshme në pronësi të institucionit ku punoni, përdorimi i funksionit tuaj, ose i burimeve financiare apo njerëzore, për të mbështetur një parti politike ose kandidati në zgjedhje, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet.

Detyrimi ose organizimi i nxënësve të arsimit parauniversitar nga drejtues apo mësues në arsimin

publik ose në arsimin jopublik, për të marrë pjesë në aktivitete zgjedhore të një partie politike ose kandidati, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Detyrimi ose kërkesa drejtuar votuesve punonjës që kryen një detyrë shtetërore, që kundër vullnetit të tyre ose nën kërcënimin e përdorimit të masave administrative ose disiplinore:

- a) për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore të një partie politike ose kandidati,
- b) për të marrë ose jo pjesë në zgjedhje,
- c) për të mbështetur ose jo një parti politike ose një kandidat në zgjedhje
- d) për të votuar në një mënyrë caktuar, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet.

## FINANCIMI I FUSHATAVE ZGJEDHORE DHE PARTIVE POLITIKE

### 20 Si financohen partitë politike?

Burimet e lejueshme për financimin e partive politike ndahen në dy kategori:

- Financim nga shteti
- Financim nga burime private

## **?** 21 Çfarë lloj mbështetje financiare nga shteti iu vihet në dispozicion partive politike?

Ka dy lloje financimi nga buxheti i shtetit. I pari është buxheti vjetor, që është një fond në mbështetje të veprimtarive vjetore të partive politike; i dyti është fondi i dedikuar për zgjedhjet që ofron mbështetje financiare për fushatën zgjedhore.

### **Financimi Vjetor i Partive Politike**

Partitë politike janë të detyruara të dorëzojnë një raport financiar vjetor duke detajuar të ardhurat dhe shpenzimet e tyre. Vetëm partitë politike që kanë dorëzuar raportin vjetor financiar sipas kërkesave kanë të drejtën të përfitojnë ndihmën vjetore financiare.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton sasinë që do t'i shpërndahet secilës parti që ka përfituar të drejtën, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Ligjin për Partitë Politike. Sipas këtij ligji:

- 70% e fondit u caktohet partive sipas numrit të vendeve në Kuvend. Ky fond ndahet ndërmjet partive në bazë të numrit të deputetëve që kanë fituar zgjedhjet e fundit parlamentare.
- 20% e fondit ndahet në mënyrë të barabartë, ndërmjet partive parlamentare dhe partive që kanë marrë mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare.
- 10% ndahet ndërmjet partive politike që kanë marrë mbi 1% të votave në zgjedhjet e fundit parlamentare.



## **Financimi i Fushatës Zgjedhore**

Kodi Zgjedhor parashikon që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve t'i shpërndajë fondet nga buxheti i shtetit partive politike për fushatën zgjedhore. Për të përfituar këto fonde, partia duhet të ketë marrë jo më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi në zgjedhjet pararendëse. Sipas ligjit, financimi lëvrohet si paradhënie në fillim të fushatës zgjedhore, por shuma përfundimtare varet nga numri i votave të marra në zgjedhje nga secila parti. Nëse shpenzimi total i një partie politike që merr pjesë në zgjedhje është më i ulët sesa shuma e dhënë si paradhënie përpara zgjedhjeve, atëherë partia duhet t'i kthejë fondet KQZ-së. Nëse nuk e bën një gjë të tillë, sipas ligjit, humbet të drejtën për të përfituar fonde publike për të paktën 5 vjet përveçse kur shlyen detyrimin bashkë me gjobat përkatëse. Në rastin e kandidatëve të pavarur apo partive politike të cilat nuk kanë garuar në zgjedhjet e mëparshme ose të cilët kanë marrë pjesë por nuk kanë kaluar pragun prej 1% të votave të vlefshme në shkallë vendi, atëherë ata nuk kualifikohen për të marrë fonde para zgjedhjeve. Vetëm në rast se ata e kalojnë pragun prej 1% në zgjedhje, atëherë KQZ-ja iu kompenson fondet përkatëse sipas parashikimit të nenit 89 të Kodit Zgjedhor.

### **Mjediset e Zyrave për Partitë Politike**

Krahas ndihmës monetare, partitë parlamentare dhe partitë që kanë marrë më shumë se 1% të votave në shkallë vendi në tre zgjedhjet e fundit parlamentare kanë të drejtë të pajisen me ambiente për zyra.

*Forma të tjera të mbështetjes nga Shteti për fushatën zgjedhore*

Krahas lëvrimeve në para për fushatën zgjedhore, partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje marrin edhe mbështetje jodirekte shtetërore në formën e minutazhit falas në RTSH, si dhe përdorimin e vendeve publike të autorizuara për të afishuar materiale propagandistike zgjedhore.

## **?22 Sa para mund të marrin partitë nga burimet private?**

Burimet private të financimit përfshijnë dhurime në para dhe në natyrë, tarifa anëtarësimi, hua/kredi, si dhe të ardhura të gjeneruara nga veprimtari të tjera të kryera nga partia. Ligji ndalon dhurime të tilla si:

- Dhurime nga shtetas të huaj (por lejon dhurime nga shqiptarë që jetojnë jashtë vendit);
- Dhurime anonime;
- Dhurime nga persona juridik apo aksionerët e tyre me konflikte të caktuara interesi (siç diskutohet më poshtë).
- Dhurime nga çdo lloj burimi i lejueshëm (apo huaje) me vlerë më shumë se 1 milionë lekë për një fushatë zgjedhore.

## **?23 Çfarë konsiderohet një dhurim anonim?**

Një dhurim anonim i referohet çdo lloj dhurimi kur dhuruesi nuk është plotësisht i identifikueshëm. Përpara se të pranojnë një dhurim, partia politike ose kandidati duhet të konfirmojë se ka informacion të plotë për emrin, adresën dhe numrin e identifikimit të dhuruesit. Siç përmendet më sipër, legjislacioni shqiptar i ndalon dhurimet anonime.

## **?24** Kujt i ndalohe të dhurojë për shkak të konfliktit të interesit?

Ndalohe dhënia e fondeve nga një person *juridik* vendas (ose ndonjë nga aksionerët e tij) nëse personi juridik:

- Ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në tre vitet e fundit, me vlerë mbi 10 milionë lekë;
- Ushtron veprimtari në fushën e medias;
- Ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme; ose
- Ka detyrime monetare ndaj Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.

## **?25** Çfarë rregullash të tjera zbatohen për dhurimet?

Rregulla të tjera të zbatueshme në lidhje me dhurimet përfshijnë:

- Të gjitha dhurimet që e kalojnë shumën mbi pesëdhjetë mijë lekë duhet (a) të dhurohen nëpërmjet një llogarie bankare të posaçme të subjektit zgjedhor dhe (b) të bëhet publike.
- Shuma totale që një dhurues (përfshirë finacimin që një kandidat mund t'i bëjë fushatës së tij/saj) nuk mund ta kalojë pragun prej 1 milionë lekë (ose në para ose në vlerën ekuivalente të dhurimit në natyrë).
- Do të ishte e jashtëligjshme shmangia e limitit të dhurimit prej 1 milionë lekë, duke ja dhënë të tjerëve paratë që t'ja dhurojnë subjektit zgjedhor.

## **?26 Çfarë është një dhurim në natyrë?**

Ndryshe nga dhurimet në para, dikush mund të ofrojë mallra ose shërbime falas ose me çmim të ulur për një parti politike apo kandidat të saj. Ky lloj dhurimi konsiderohet si një dhurim në natyrë i cili ka gjithashtu një kundërvlerë të caktuar monetare. Edhe dhurimet në natyrë, njësoj si dhurimet në para, janë të detyrueshme për t'u raportuar nga partitë apo kandidatët. Por nëse dikush ofron kohën e tij/saj pa pagesë për të ndihmuar fushatën, p.sh., shpërndarjen e fletushkave disa orë gjatë fundjavës, atëhere konsiderohet si 'aktivitet vullnetar' dhe jo një dhurim në natyrë.

## **?27 Çfarë do të thotë “të ardhura të gjeneruara nga aktivitetet e tjera të kryera nga partia”?**

Ligji për Partitë Politike i lejon partitë politike që ta përdorin pronën dhe ambientet e tyre për aktivitete të ndryshme nga të cilat ata mund të gjenerojnë të ardhura. Këto përfshijnë publikimet, shtypin e shkruar, shërbimet dhe dhënie me qira. Të ardhurat e përfituara nga këto aktivitete mund të përdoren për financimin e partive politike apo edhe të fushatës zgjedhore dhe duhet të raportohen si çdo burim tjetër që përfiton partia ose kandidati.

## **?28 A ka limit lidhur me totalin e shpenzimeve që një partie politike mund të kryejë për fushatën zgjedhore?**

Po, ka një limit shpenzimi për fushatën zgjedhore. Limiti i shpenzimit për një parti politike të regjistruar në zgjedhje, është sa trefishi e shumë më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike

Limiti vlen për të gjitha shpenzimet e kryera, qoftë nga selia e partisë politike, zyrat vendore ose kandidatët e saj. Çdo shpenzim që kryhet për qëllime të fushatës zgjedhore, pavarësisht datës kur është kryer qoftë nga partia apo nga kandidati, duhet të përfshihet në raportin e fushatës zgjedhore.

## **?29 Çfarë parashikon ligji për transparencën e partive dhe financimin e zgjedhjeve?**

Kushtetuta e Shqipërisë parashikon se financimi i partive politike duhet të jetë transparent në çdo moment. Gjithashtu, Ligji për Partitë Politike dhe Kodi Zgjedhor kërkon raportimin dhe publikimin e financimit të partive dhe të zgjedhjeve.

Duke nisur nga viti 2017, KQZ-ja publikon online raportet e financimit të fushatës së të gjitha subjekteve politike, në një format standard. Gjithashtu, KQZ-ja publikon në faqen e saj zyrtare në internet raportet e monitorimit të shpenzimeve të fushatës, pasqyrat financiare vjetore të partive, dhe raportet e audituesve.

## **30** Kush duhet të dorëzojë raportet e financimit të fushatës?

Të gjitha partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, duhet të raportojnë financimet e fushatës së tyre zgjedhore. Gjithashtu, kandidatët për kryetarë bashkie dhe kandidatët e listave shumëemërore raportojnë financimet e fushatës zgjedhore nëpërmjet partisë politike që përfaqësojnë.

KQZ ka miratuar një format raportimi të financimit të fushatës zgjedhore për partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe një tjetër për kandidatët për kryetarë bashkie. Ndërkohë që partitë politike raportojnë drejtpërdrejtë tek KQZ, kandidatët për kryetarë bashkie dhe kandidatët e listave shumëemërore raportojnë tek personi përgjegjës për financat pranë partisë së tyre. Raportet më vonë auditohen nga KQZ-ja dhe subjektet zgjedhore duhet të vënë në dispozicion çdo informacion të nevojshëm për qëllimet e auditimit.

## **31** Çfarë informacioni duhet të përfshihet në raportet e financimit të fushatës zgjedhore?

Të gjitha të ardhurat e përfituara, dhuratat në natyrë, kreditë (nëse ka) dhe shpenzimet e kryera për qëllime të fushatës zgjedhore duhet të përfshihen në këto raporte. Kandidatët për kryetarë bashkie dhe kandidatët e listave shumëemërore duhet të dorëzojnë raportet te partitë e tyre politike brenda 30 ditëve nga shpallja e rezultateve të zgjedhjeve. Më pas, partia politike e përfshijnë informacionin e kandidatëve në një raport të konsoliduar, i cili duhet të publikohet dhe të dorëzohet në KQZ brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultateve të zgjedhjeve.

## **?** 32 **Si e monitoron KQZ-ja fushatën zgjedhore?**

Në periudhën gjashtë muaj para datës së zgjedhjeve, KQZ-ja cakton një numër monitoruesish të cilët kanë për detyrë të monitorojnë aktivitetet e fushatës zgjedhore dhe për t'u siguruar që partitë politike po respektojnë detyrimet ligjore që ata kanë në lidhje me financimin e fushatës, si p.sh. vendosjen e materialeve propagandistike apo shpërdorimin e mundshëm të burimeve shtetërore. Në rastet kur monitoruesit evidentojnë shkelje, por edhe në mënyrë periodike, ato raportojnë në KQZ dhe KQZ-ja sipas rastiit do të marrë masat për të korrigjuar në kohë reale shkeljen në fjalë ose do të ndërmarrë masë administrative nëse një subjekt i caktuar është gjetur në shkelje të ligjit në përfundim të hetimit administrativ.

## **?** 33 **Kush mund të denoncojë dhe si bëhet denoncimi në KQZ?**

Nëse dikush ka të dhëna të besueshme për një shkelje ligjore në lidhje me financimet nga ana e partive apo kandidatëve, atëherë denoncuesi mund të përdorë portalin për denoncimet në faqen e KQZ-së ku duhet të tregojë objektin e kallëzimit, të bëjë një përkthim të shkeljes ligjore, dhe të tregojë për ekzistencën e provave në lidhje me rastin në fjalë. KQZ-ja pasi vlerëson informacionin e marrë nga denoncimi mund të vendosë të bëjë verifikimet e nevojshme dhe të nisë hetimin administrativ, në përfundim të të cilit del me një vendim të caktuar.

## 34 Çfarë sanksionesh parashikohen për shkeljen e ligjit?

Ligji parashikon disa sanksione në rast të shkeljeve të mundshme në lidhje me financimin e fushatës. Sanksionet ndryshojnë në varësi të natyrës së shkeljes, që nga shuma 50.000 lekë deri në pezullim të financimit të partisë deri në 5 vjet. Për më shumë detaje referojuni Neni 173 të Kodit Zgjedhor.

Gjithashtu edhe Ligji për Partitë Politike, Neni 23/4 parashikon sanksione. Për shembull, shkelja e afatit të dorëzimit të raportit financiar në kohën e duhur apo paraqitja e raporteve në shkelje të formateve të standardizuara, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë. Dhurime nga dhurues të paidentifikuar kalojnë për llogari të KQZ-së dhe dhurimet që e tejkalojnë limitin e përcaktuar dënohen me gjobë në masën 30 për qind të shumës së dhuruar.

KQZ zbaton parimin e proporcionalitetit kur vlerëson sanksionet dhe merr parasysh faktorët e mëposhtëm:

- Rrethanat e shkeljes
- Rëndësinë e shkeljes
- Nëse subjekti zgjedhor është përsëritës
- Pasojat e veprimeve/mosveprimeve të shkelësit
- Sjelljen e subjektit zgjedhor ndaj rekomandimeve të Komisionit dhe shkallën e bashkëpunimit të shfaqur gjatë procesit të verifikimit.



## **? 35** Çfarë hapash ndërmarrin sa i përket mbikëqyrjes dhe respektimit të ligjit?

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent i ngarkuar me ligj për të mbikëqyruar përputhshmërinë me ligjin dhe për të siguruar transparencën e financimit politik. Gjithsesi, partitë politike, kandidatët, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët, të gjithë luajnë një rol për të siguruar zbatimin e ligjit.

Mbikëqyrja e partive dhe financimeve të zgjedhjeve është shumëdimensionale dhe konsiston në:

- Monitorimin nga monitoruesit e emëruar nga KQZ-ja gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore;
- Auditimin e raporteve të financimit të fushatës zgjedhore nga auditues ligjorë të pavarur;
- Marrjen në konsideratë të çështjeve të ngritura tek KQZ nga palë të treta (p.sh., ankimime, denoncime, etj);
- Shqyrtimin e financimit të fushatës, monitorimit financiar dhe raportet e auditëve nga ana e KQZ-së.

## MODELE NDERKOMBETARE TE NDALIMIT TE PERDORIMIT TE MEDIAVE SOCIALE NGA FUNKSIONARET PUBLIK NE ZGJEDHJE

### **36** Këshilla praktike për zyrtarët publikë lidhur me postimet në mediat sociale sipas praktikave më të mira ndërkombëtare?

1. Mos shpërndani ose rishpërndani opinione politike ose përmbajtje të postuara nga parti politike ose politikanë.
2. Mos postoni në rrjetet sociale imazhe ose përditësime për çështje që janë politikisht të diskutueshme.
3. Monitoroni faqen tuaj dhe fshini çdo përmbajtje që është politikisht e diskutueshme.
4. Mos organizoni një fushatë të rëndësishme të bazuar në mediat sociale nëse nuk mund të demonstrohet se ajo ishte planifikuar përpara shpalljes së zgjedhjeve.
5. Profilet e rrjeteve sociale të Kryetarit të Bashkisë ose Minsitrave mund të ri-tëeetohen ose rishpërndahen vetëm për sa kohë që nuk janë të natyrës politike.

### **37** Cilat janë dallimet mes llogarive personale dhe llogarive institucionale në rrjetet sociale?

Llogaritë e hapura në emër dhe për llogari të institucionit public, të financuara nga taskat e qyetarëve janë të ndalaura për tú përodrur për qëllime zgjedhore. Përdorimi i tyre duke shpërndarë psotime me natyrë politikepërbën:

**a** Keqpërdorim të burimeve shtetërore.

**b** Shkelje të kodit penal, neni 328/a.

### **? 38 A ndalohen reklamat politike sipas standarteve të BE?**

**a** Reklamat politike duhet të përmbajnë një shënim/etiketë të dallueshme ku të përfshihet informacion, kush e ka paguar reklamën, zgjedhjet apo referendumin që i përket reklama dhe shumën e paguar.

**b** Reklamat politike të targetuara do të lejohen vetëm në kushte shumë strikte. Të dhënat duhet të mbliidhen nga subjekti i të dhënave dhe mund të përdoren vetëm pasi subjekti i të dhënave të ketë dhënë pëlqimin e veçantë për përdorimin e tyre për reklama politike. Kategoritë e veçanta të të dhënave personale, që zbulojnë origjinën racore apo etnike apo opinionet politike, nuk mund të përdoren për profilizim.

## **LEGJENDA E SHKELJEVE TË KONSTATUARA NË ZGJEDHJE**

### **? 39 Zhvillimi i takimit elektorale në shkollë (neni 91, pika 2, Kodi Zgjedhor)**

*“Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i*

institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nënpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.”

#### **?40 Zhvillim i fushatës në institucion publik (Neni 78, pika 6, Kodi Zgjedhor)**

“Ndalohet zhvillimi i fushatës zgjedhore në institucionet publike.”

#### **?41 Vendosi e posterave elektoral në institucion publik (Udhëzimi nr.6, datë 23.03.2021, i KSHZ-së)**

#### **?42 Subjektet zgjedhore/kandidatët i ofrojnë ose japin para, të mira materiale, premtojnë vende pune (neni 78, pika 7, Kodi Zgjedhor).**

“Subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve u ndalohet dhe mbajnë përgjegjësi penale në rast se ofrojnë ose japin të holla, të mira materiale, premtojnë për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me

qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtaritë paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike.”

**?43 Subjekti zgjedhor/kandidati organizon ose mbulon shpenzimet për koncerte, evente kulturore dhe argëtuese ose aktivitete bamirësie (Neni 78, pika 9, Kodi Zgjedhor)**

“Subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve u ndalohet të organizojnë, kryejnë apo mbulojnë shpenzimet vetë ose nëpërmjet të tretëve për koncerte, shfaqje kulturore argëtuese apo veprimtari bamirësie, pavarësisht nëse ato mbahen përgjatë ose në lidhje me tubimet elektorale, apo zhvillohen si veprimtari fushatë ose jashtë saj.”

**?44 Subjekti zgjedhor/Kandidati që ofron artikuj ose materiale të printuara me vlerë prej më shumë se 5(pesë) qind Lekë për artikuj ose materiale zgjedhore (Neni 78, pika 10, Kodi Zgjedhor)**

“Nuk përbën shkelje dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët lejohet të ofrojnë sende dhe materiale të printuara fushate kur vlera e tyre është më e vogël se pesë qind lekë për send ose material. KQZ-ja mban dhe përditëson listën e sendeve apo materialeve të lejuara për fushatë, me vlerat maksimale për secilin prej tyre.”

**?45 Paraqitja e materialeve propagandistike statike më shumë se 5 metra nga zyrat zgjedhore (Neni 79, pika 2, Kodi Zgjedhor)**

*“Gjatë fushatës zgjedhore përdorimi dhe afishimi i çdo materiali tjetër statik për propagandë zgjedhore, përfshirë flamujt dhe posterat, lejohet vetëm në një largësi prej deri 5 metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës.”*

**?46 Mos përfshirja e deklaratës së autorizimit në materialet vizive të fushatës propagandistike (Neni 79, pika 3, Kodi Zgjedhor)**

*“Të gjitha materialet propagandistike vizive që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin: “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...” (vijon emri i subjektit zgjedhor).”*

**?47 Zyrat zgjedhore janë hapur në një distancë më të vogël se 300 metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve. (Udhëzimi nr.6, datë 23.03.2021, i KSHZ-së)**

**?48 Përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qellime zgjedhor (Neni 91, pika 2, Kodi Zgjedhor)**

*“Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i*

administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nënpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.”

### **?49 Punësimi, pushimi nga puna, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucione ose ente publike gjatë fushatës zgjedhore, përveç rasteve të justifikuara (Neni 91, pika 3, Kodi Zgjedhor)**

“Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të raste vetë përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë.”

### **?50 Ndalimi në propozimin, aprovimin ose nxjerrjen e akteve ligjore ose akteve nënligjore që**

## **përfitojnë kategori të caktuara të njerëzve (p.sh. rroga, rritja e pensionit, amnistia fiskale) (Neni 91, pika 4, Kodi Zgjedhor)**

*“Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re paszgjedhjeve ndalohej propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet qëparashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.”*


## **?51 Mosraportimi i aktiviteteve të natyrës publike të kryer nga institucione publike vendore dhe qendrore, si dhe agjensi shtetërore dhe/ose ndërmarrje (Neni 92, pika 1 dhe 6, Kodi Zgjedhor)**

*“Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjensitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre.”*



*“Mosraportimi i veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ ose ndërmarrjeve shtetërore, ose zhvillimi i tyre, pavarësisht ndalimit nga KQZ-ja ngarkon me përgjegjësi personin përgjegjës, si dhe titullarin përkatës të institucionit kur ai ka penguar zbatimin e kësaj dispozite.”*

**?** **52** **Kryerja e aktiviteteve të ndaluara nga KQZ-ja**  
(Neni 91, pika 5, Kodi Zgjedhor dhe vendimi nr.9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator)



**MANUAL PËR AKTIVITETIN E  
NËNPUNËSVE TË ADMINISTRATËS  
PUBLIKE NË ZGJEDHJE**



Qëndresa  
Qytetare



Funded by  
the European Union